

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6504  
E premte, 7 janar 2022  
çmimi 0.40 €

Szunyogu: Kosova të  
kërkojë nga shtetet  
anëtare të BE-së  
mbështetje për vizat



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

LËVIZJA VETËVENDOSJE DHE PARTIA DEMOKRATIKE  
E KOSOVËS "THYEJNË AKULLIN" | FAQE 4-5

## VETËVENDOSJA DHE PDK-ja BËHEN BASHKË NË GJILAN

- Lëvizja Vetëvendosje ka bërë koalicion me PDK-në  
për qeverisje në Gjilan



Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK) kanë "thyer akullin". Të enjten këto dy parti kanë lënë mbrapa mospajtimet dhe akuzat për njëra-tjetrën dhe janë pajtuar të bashkëqeverisin në komunën e Gjilanit për katër vjetët e ardhshëm. Koalicioni i parë zyrtar në mes të këtyre dy partive politike parashihet që pozita e nënkryetarit të komunës dhe katër drejtorit t'i takojnë PDK-së. Marrëveshja për koalicion qeverisës është mirëpritur nga ish-anëtarët e këtyre dy partive

### AKTUALE



QEVERIA SËRISH INJORON  
KOMUNAT PËR PANDEMINË | F. 7

MINISTRJA NAGAVCI: S'KA  
VEND PËR GREVA NË SEKTORIN  
E ARSIMIT | F. 6

HAMZA KËRKON MBËSHTETJE NGA  
GJERMANIA DHE IZRAELI PËR  
ZHVILLIMIN E MITROVICËS | F. 6

### EKONOMI



DOGANA NË VITIN 2021  
GRUMBULLOI 1.37 MILIARD EURO | F. 8


MURATI PËR NDALIMIN  
E KRYPTOVALUTAVE: KA QENË  
E NEVOJSHME TË KUFIZOHET  
PRODHIMI I TYRE | F. 8

### SPORT



HASANI RIKTHEHET TE SHKËNDIJA:  
RIKTHEHEM QË TA SJELL TITULLIN  
KAMPION | F. 10

Vazhdon rritja e  
rasteve të reja me  
Covid | FAQE 3



OPERACIONI 'BREZOVICA', ARRESTOHEN  
ISH-SEKRETARI DHE KRYEINSPEKTORI I  
MINISTRISË SË MJEDISIT

| FAQE 3

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@ml.net.mk](mailto:renova@ml.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Blinken: Pasoja masive për Rusinë nëse pushton Ukrainën

WASHINGTON, 6 JANAR - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, ka paralajmëruar se Rusia duhet ta largojë presionin ndaj Ukrainës nëse dëshiron përparim, pasi ai ka rikonfirmuar një paralajmërim për "pasoja masive" në rast të pushtimit. Rusia dhe Shtetet e Bashkuara mbajnë bisedime javën e ardhshme në Gjenevë pasi Moskë ka grumbulluar dhjetëra mijëra trupa në kufirin ukrainas dhe i ka kërkuar Perëndimit garanci kundër zgjerimit të aleancës së NATO-s. "Nëse bisedimet do të tregojnë përparim të vërtetë, kjo do të kërkojë depërshkallëzimin", ka thënë Blinken në një konferencë të përbashkët për medie me ministren e Jashtme gjermane, Annalena Baerbock.

Duke vënë në dukje shpresat e Rusisë për përparim në fusha të tilla si kontrolli i armëve, Blinken ka thënë se "është shumë e vështirë të bësh përparim aktual në ndonjë nga këto fusha në një atmosferë përshkallëzimi dhe kërcënimi me një armë të drejtuar nga koka e Ukrainës". "Rusia nuk duhet të ketë asnjë dyshim se agresioni i mëtejshëm ushtarak kundër Ukrainës do të kishte pasoja masive dhe kosto të rënda si përgjigje", ka thënë Blinken. Ministrja e Jashtme e Gjermanisë, Annalena Baerbock, duke bërë vizitën e saj të parë në Uashington që nga marrja e detyrës, u pajtua me nevojën për "pasoja të rënda" nëse Rusia sulmon Ukrainën. Shtetet e Bashkuara dhe Gjermania kanë qenë në



mosmarrëveshje për vite me radhë mbi projektin e gazsjellësit "Nord Stream 2", i cili do ta hapë dhe dërgojë gazin rus drejtpërdrejt në ekonominë më të madhe të Evropës. "Nga këndvështrimi ynë, është

shumë e vështirë të shihet që gazi që rrjedhë përmes atij tubacioni të bëhet operacional nëse Rusia vazhdon agresionin e saj", ka thënë sekretari Blinken. Edhe pse shkaktoi kritika në vend, administrata e presidentit

Joe Biden ka refuzuar të vendosë sanksione mbi gazsjellësin Nord Stream, duke thënë se ishte praktikisht i përfunduar. Por administrata amerikane vitin e kaluar arriti një marrëveshje në të cilën Gjermania premtoi ndihmë për Ukrainën dhe paralajmëroi Rusinë kundër përdorimit gazsjellësit për avantazhe gjeopolitike. Ministrja e Jashtme e Gjermanisë, Annalena Baerbock, e pyetur nëse Gjermania ishte gati ta anulonte gazsjellësin, ka thënë vetëm se qeveria e re e ka mbështetur marrëveshjen e vitit të kaluar me Shtetet e Bashkuara. "Qeveria e re është pajtuar që ne të marrim masa efektive së bashku me partnerët tanë evropianë nëse Rusia përdor energjinë si armë" ka thënë ajo.

## Franca gjobit "Google"-n dhe "Facebook"-un me gjoba të ashpra



PARIS, 6 JANAR - Rregullatorët francezë kanë goditur kompanitë "Google" dhe "Facebook" me 201 milionë euro gjobë për shkak të përdorimit të mekanizmit për gjurmim online të përdoruesve, kanë thënë autoritetet më 6 janar. Gjoba prej 150 milionë eurosh ndaj "Google"-s është lëshuar nga Komisioni Kombëtar i Francës për Teknologji Informativ dhe Liri.

Ky institucion ka gjobitur gjigantin "Google" me gjobë prej 100 milionë eurosh edhe në dhjetor të vitit 2020. "Komisioni ka vërtetuar se faqet

'facebook.com', 'google.fr' dhe 'youtube.com' nuk u mundësojnë përdoruesve që ta refuzojnë përdorimin e të dhënave të tyre me aq lehtësi sa të pranojnë këtë kërkesë", ka thënë trupi rregullativ.

Të dyja platformat kanë tre muaj kohë për t'i ndryshuar praktikën, pasi më vonë Franca do të vendosë gjoba prej 100 000 eurosh në ditë.

"Google" ka thënë për agjencinë e lajmeve "AFP" se do t'i ndryshojë praktikën e veta. "Në përputhje me pritshmëritë e përdoruesve të internetit, ne jemi të përkushtuar

për të zbatuar ndryshime të reja, si dhe të punojmë me komisionin francez pas vendimit të tij", ka thënë kompania amerikane përmes një deklarate.

I njohur si "cookies", ky mekanizëm i të dhënave formohet në kompjuterin e përdoruesve kur ata vizitojnë një faqe, çfarë u mundëson kompanive të ruajnë informacionin rreth vizitës së faqes.

Ky mekanizëm është shumë i rëndësishëm për "Google" dhe "Facebook" si mënyrë për t'i personalizuar reklamën - burimin kryesor të të hyrave.

## BE-ja: Kemi metodat tona për sanksione ndaj liderëve të Ballkanit

Bruksel, 6 janar - Bashkimi Evropian (BE) "ka marrë në dijeni" vendimin e administratës amerikane për vendosjen e sanksioneve ndaj liderit të serbëve të Bosnjë e Hercegovinës, Millorad Dodik dhe bashkëpunëtorëve të tij. Por, zyrtarët në BE nuk u janë përgjigjur prerë pyetjeve të gazetarëve nëse blloku evropian do të ndjekë këtë shembull të Shteteve të Bashkuara dhe të vendosë sanksione.

Zëdhënësja e Komisionit Evropian për çështje të zgjerimit, Ana Pisonero, ka thënë se "BE-ja ka një varg instrumentesh, përfshirë edhe mundësinë e sanksioneve, por për përdorimin e

tyre vendimi duhet të miratohet në Këshillin e BE-së me konsensusin e të gjitha shteteve anëtare".

Këto mekanizma BE-ja i ka në dispozicion që nga viti 2011, por në BE nuk kanë pasur përgjigje as në pyetjen se sa vlejné mekanizmat nëse ato nuk përdoren dhe se a e dobëson kjo pozicionin e BE-së në rajon.

Zëdhënësja e Komisionit Evropian ka thënë se BE-ja mbështet të gjitha përpjekjet për gjetjen e shpejtë të zgjidhjes për krizën politike në Bosnjë e Hercegovinë dhe ndaljen e të gjitha nismave të papranueshme, të cilat vënë në rrezik sovranitetin dhe integritetin territorial të këtij



shteti.

Pisonero ka thënë se Bosnja e Hercegovina do të ketë pasoja në mungesë të gjetjes së rrugëdaljes nga kjo krizë dhe këto pasoja

mund të jenë edhe në humbjen e mjeteve të shumta financiare nga Plani Evropian për investime në Ballkanin Perëndimor. Ajo shtoi se ndihma financiare është e

kushtëzuar edhe me procesin e reformave dhe luftën kundër krimin të organizuar dhe korrupsionit.

Gjermania para disa javësh publikisht ka përmendur idenë që BE-ja ta përdorë mundësinë për ta sanksionuar Millorad Dodikun. Por, për një gjë të tillë nuk ka pasur pajtim nga të gjitha shtetet anëtare në Këshill.

ShBA-ja tha se ka zgjeruar sanksionet ndaj Dodikut për vepra korruptive, duke e akuzuar atë se po minon institucionet "duke bërë thirrje për marrjen e kompetencave shtetërore dhe duke iniciuar krijimin e institucioneve paralele në entitetin e Republikës Serpska të Bosnjë e Hercegovinës".



## Szunyogu: Kosova të kërkojë nga shtetet anëtare të BE-së mbështetje për vizat

PRISHTINË, 6 JANAR - Shefi i Zyrës i Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomas Szunyog, ka thënë se e kupton rëndësinë e liberalizimit të vizave për Kosovën dhe frustrimin e kosovarëve që duan të udhëtojnë jashtë vendit. Megjithatë, ai ka dhënë disa këshilla për Kosovën edhe pse janë përmbushur kriteret për liberalizimin e vizave. Në një shkrim autorial të titulluar "Optimizmi do ta takojë realitetin. Rreth të ardhmes evropiane për Kosovën", Szunyogu ka shkruar se Kosova në këtë situatë mund të flasë me shtetet anëtare që hezitojnë ta mbështesin në liberalizimin e vizave. "Jam shumë i vetëdijshëm për rëndësinë e liberalizimit të vizave dhe e kuptoj frustrimin për faktin se njerëzit në Kosovë ende kanë nevojë për vizë për të udhëtuar në zonën Schengen. Në këtë kuptim, Komisioni Evropian mban vlerësimin e bërë në korrik 2018 se Kosova i ka përmbushur të gjitha standardet për liberalizimin e vizave. Ky propozim është në pritje në Këshill", ka shkruar Szunyogu. Por, ai ka propozuar që Kosova "t'i shfrytëzojë" disa mundësi, duke u angazhuar në një dialog me shtetet anëtare të BE-së për ta marrë mbështetjen e nevojshme në këtë çështje. "Kosova ka një mundësi për t'u angazhuar në një dialog me shtetet anëtare për ta kërkuar mbështetjen e tyre, si dhe për të qenë e gatshme ta adresojë çdo shqetësim që disa mund ta kenë ende", ka shkruar Szunyogu, duke shtuar se që kjo të ndodhë, Kosova duhet të fokusohet në politikat ekonomike, garancitë e

sundimit të ligjit dhe standardet e nevojshme për tërheqjen e investimeve. "Ajo që ka rëndësi janë vendimet konkrete, legjislacioni i miratuar, masat e zbatuara dhe strukturat në fuqi", ka shkruar ai.

Szunyogu është shprehur i lumtur me mbështetjen që qytetarët e Kosovës ia japin anëtarësimit të Kosovës në BE. Kjo ka thënë se i jep motivim për ta vazhduar punën e tij në Kosovë dhe që ta përshejtojë rrugën e saj drejt BE-së.

Si zhvillime pozitive të vitit të kaluar, Szunyogu ka theksuar zgjedhjet parlamentare dhe ato lokale për të cilat ka thënë se kanë dëshmuar për pjekurinë demokratike të Kosovës, pasi ishin të administruara mirë, transparente dhe të drejta, pavarësisht disa mangësive. "Zgjedhjet e përgjithshme rezultuan në një qeveri të fortë me një shumicë të qëndrueshme në parlament dhe me një agjendë ambicioze reformash. Për më tepër, viti ka shënuar rritje të mirë ekonomike. Rimëkëmbja ekonomike e Kosovës ka tejkaluar parashikimet. Kosova, si shumë prej nesh, ka luftuar me pandeminë këtë vit, por po hyn në vitin e ri me nivele të ulëta të infektiveve dhe shkallë relativisht të lartë të vaksinimit. Kosova po e nis vitin me një notë të fortë dhe ka arsye për të qenë optimistë për të ardhmen", ka shkruar ai.

Këtë vit Szunyogu ka thënë se është koha për ta përmirësuar jetën e të gjithë qytetarëve të Kosovës. Qeveria aktuale, ka thënë



Szunyogu, mund të marrë vendime të rëndësishme për këto çështje, duke u mbështetur në mundësitë e ofruara nga Bashkimi Evropian. Duke vazhduar me Raportin vjetor të Progresit për Kosovën, ai ka thënë se vendi duhet të zbatojë reforma konkrete. "Kosova mund të bëjë më mirë; njerëzit meritojnë më mirë. BE-ja jo vetëm që ofron mundësi, por është e gatshme ta ndihmojë Kosovën për shfrytëzimin maksimal të tyre, në partneritet të ndershëm dhe respekt të ndërsjellë. BE-ja e ka mbështetur

Kosovën edhe financiarisht. BE-ja është këtu për ta vazhduar mbështetjen e Kosovës për t'i shfrytëzuar të gjitha mundësitë; gjithçka varet nga përkushtimi i Kosovës", ka shkruar shefi i Zyrës i BE-së në Kosovë.

Procesi i anëtarësimit të Kosovës në Bashkimin Evropian, sipas tij, varet nga rezultatet konkrete dhe të qëndrueshme në disa çështje si sundimi i ligjit, reforma në drejtësi, lufta kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, siguria, të drejtat themelore, reforma e administratës publike, zhvillimi

ekonomik dhe konkurrueshmëria. "Procesi është i gjatë dhe kompleks, por shpërblimi ia vlen: një Kosovë stabile, e begatë, demokratike dhe paqësore", ka shkruar ai.

Pas urimit, Szunyogu e ka përmbullur shkrimin autorial, duke thënë se Kosova ka mundësi reale që ta bëjë të ardhmen e saj më të mirë. "BE-ja është e gatshme ta ndihmojë Kosovën që t'i afrohet BE-së, por ne nuk mund ta bëjmë pa ju: në fund të fundit, është zgjedhja dhe përgjegjësia e Kosovës", ka shkruar ai.

## Operacioni "Brezovica", arrestohen ish-sekretari dhe kryeinspektori i Ministrisë së Mjedisit

PRISHTINË, 6 JANAR - Nga shtatë të arrestuarit gjatë bastisjeve në kuadër të operacionit "Brezovica", dy prej tyre janë zyrtarë të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës të cilët dyshohen për keqpërdorim të detyrës zyrtare - marrje rryshfeti, si dhe pesë (5) qytetarë të dyshuar për dhënie të rryshfetit", është thënë në njoftimin e Prokurorisë Themelore të Ferizajt.

Më 21 dhjetor të vitit të kaluar Policia e Kosovës ka kryer një aksion në Shtërpcë lidhur me ndërtimet, ku ka arrestuar dhjetë persona. Në mesin e tyre është edhe Bratislav Nikolliq, ish-kryetar i komunës së Shtërpcës dhe zyrtar i Listës Serbe.

Arrestimi i tyre është bërë nën dyshimin për vepra penale si keqpërdorim i detyrës zyrtare, marrje dhe dhënie e rryshfeti, gjegjësisht për dhënie të lejeve për ndërtimet në Brezovicë.

Prishtinë. "Deri me tani janë arrestuar shtatë (7) persona, dy prej tyre janë zyrtarë të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës të cilët dyshohen për keqpërdorim të detyrës zyrtare - marrje rryshfeti, si dhe pesë (5) qytetarë të dyshuar për dhënie të rryshfetit", është thënë në njoftimin e Prokurorisë Themelore të Ferizajt.

Në pranga si të dyshuar për keqpërdorim të detyrës apo autoritetit zyrtar dhe marrje të rryshfetit kanë përfunduar ish-sekretari i Ministrisë së Ambientit, Arben Çitaku dhe Bedri Halimi, kryeinspektor në këtë ministri.

Nga dhjetë lokacionet që janë bastisur të enjten në vazhdim të operacionit "Brezovica" janë arrestuar shtatë persona. Në të njëjtin operacion, rreth dy javë më parë, Policia e Kosovës kishte arrestuar edhe dhjetë persona të tjerë.

Bastisjet e së enjtes kanë përfunduar në Ferizaj e në Shtërpcë, ndërsa pritet të përfundojnë së shpejti edhe në







LËVIZJA VETËVENDOSJE DHE PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS "THYEJNË AKULLIN"

## Vetëvendosja dhe PDK-ja bëhen bashkë në Gjilan

- Lëvizja Vetëvendosje ka bërë koalicion me PDK-në për qeverisje në Gjilan

Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK) kanë "thyer akullin". Të enjten këto dy parti kanë lënë mbrapa mospajtimet dhe akuzat për njëra-tjetrën dhe janë pajtuar të bashkëqeverisin në komunën e Gjilanit për katër vjetët e ardhshëm. Koalicioni i parë zyrtar në mes të këtyre dy partive politike parasheh që pozita e nënkryetarit të komunës dhe katër drejtori t'i takojnë PDK-së. Marrëveshja për koalicion qeverisës është mirëpritur nga ish-anëtarët e këtyre dy partive

Komunal do të jetë nga PDK-ja, por jo kryesuesi i asamblesë", ka thënë Kurteshi.

Kurse ushtruesi i detyrës i kryetarit të Degës së PDK-së në Gjilan, Riad Shatri, ka treguar se kësaj partie do t'i takojnë katër drejtori. Ai ka bërë me dije se bëhet fjalë për Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave, Drejtorinë e Bujqësisë, Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik. Kjo marrëveshje ka bërë të mundur që të enjten pasdite Arianit Sadiku nga LV-ja të zgjedhet kryesuesi i Kuvendit Komunal të Gjilanit. Në këtë garë ai ka marrë 18 vota, kurse Shpresa Kurteshi-Emini, e cila ishte propozuar nga LDK-ja, ka marrë 17 vota.

Kryesitë qendrore të dy partive nuk kanë pasur ndonjë reagim për marrëveshjen e parë për bashkëqeverisje. Zëdhënësi i PDK-së, Faton Abdullahu, ka deklaruar se për koalicionet qeverisëse në komunat e

Kosovës vendosin vetë degët e kësaj partie dhe jo kryesia qendrore. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se ky decentralizim në vendimmarrje është dizajnuar nga kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi. "Për shkak se degët e partisë janë të involuara dhe bashkëjetojnë në forma të ndryshme me problemet e qytetarëve në komuna, janë ato që marrin vendime për koalicionet e mundshme. Kjo qasje e re e dizajnuar nga kryetari Krasniqi është treguar progresiv", ka thënë Abdullahu. Sipas tij, kjo mënyrë e vendimmarrjes i bënë degët e partisë më të përgjegjshme në raport me votuesit e PDK-së. "Ky lloj decentralizmi në vendimmarrje për koalicione të mundshme në komuna i aktivizon degët në përgjithësi më shumë dhe i bënë ato edhe më të përgjegjshme. Më e rëndësishmja është se kështu partia detekton më mirë problemet dhe nevojat e qytetarëve dhe, për rrjedhojë,

krijon premisa optimale për t'i zgjedhur ato", ka thënë Abdullahu.

**Mirëpritet marrëveshja  
LV - PDK**

Bashkëpunimi i parë në mes të LV-së dhe PDK-së është mirëpritur nga ish-anëtarët e këtyre dy partive. Ish-zyrtari i lartë i LV-së dhe PSD-së, Dardan Sejdiu, ka thënë se ky bashkëpunim është një lajm i mirë për Kosovën. "Ky është lajm i mirë për Kosovën. Më në fund po vendoset në normalitet marrëveshja politike për qeverisje! Fillim i mbarë i vitit 2022. Sa më shumë diskutim e bashkëpunim, sa më pak etiketa përgjithësuese, aq më mirë për vendin. Ecim përpara vetëm me punë dhe bashkëpunim", ka shkruar Sejdiu.

Kurse ish-kryetari i Gjilanit dhe ish-kryetari i Degës së PDK-së në Gjilan, Qemajl Mustafa, ka thënë se kjo marrëveshje për bashkëqeverisje ka qenë më e natyrshme. "Lidhja LV-PDK për

**EPOKA E RE**

**Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 6 JANAR** - Lëvizja Vetëvendosje ka lënë anash akuzat e rënda ndaj Partisë Demokratike të Kosovës dhe është pajtuar që me këtë parti të bashkëqeverisin në komunën e Gjilanit për katër vjetët e ardhshëm. Këto dy parti kanë bërë marrëveshjen e parë zyrtare për bashkëqeverisje. Përfaqësuesit e të dy partive kanë treguar disa të hollësi të

marrëveshjes. Asamblisti i Lëvizjes Vetëvendosje në Gjilan, i cili dikur ishte pjesë e PDK-së, Ismajl Kurteshi, ka konfirmuar për mediet se marrëveshja parasheh që pozita e nënkryetarit t'i takojë partisë së tretë në Gjilan. "Po, mund të konfirmoj se kemi arritur marrëveshje me PDK-në dhe disa subjekte të vogla. Lidhur me koalicionin do të dalim me detaje më vonë. Por marrëveshja është arritur dhe do ta votojmë sot. Nënkyetari i Kuvendit



# Të mbyllur dhe pa internet, shqiptari nga Kosova rrëfen situatën në Kazakistan

**NUR SULTAN, 6 JANAR** - Me të përfunduar një ditë normale pune, Kastrioti (identiteti i vërtetë i të cilit është i njohur për redaksinë), një shqiptar nga Kosova që po qëndron në Kazakistan, i është dashur të mbyllet në banesë. I shqetësuar dhe pa shumë informacione, ky i ri në të 20-at është duke pritur të shohë se çfarë do të ndodhë me trazirat e protestave që e kanë kapluar këtë vend.

Kastrioti, që ka folur për "Radion Evropa e Lirë" në kushte anonimiteti, ka nisur të punonte në shtetin e Azisë Qendrore më 2021 përmes kompanisë "Mabetex Group", në pronësi të Behgjet Pacollit, ish-presidenti i Kosovës.

Një valë e protestave masive ka nisur në Kazakistan tash e katër ditë për shkak të rritjes së papritur të çmimit të gazit të lëngshëm i cili përdoret për makina në shtetin e pasur me naftë.

Kastrioti, së bashku me punëtorë të tjerë nga Kosova, po jeton në kryeqytetin Nur Sulltan. Ai ka thënë se gjendja momentale atje është më e qetë në krahasim me qytetet e tjera si Almati por, sipas urdhrat të autoriteteve, janë të mbyllur në banesë.

"Na kanë mbyllur, nuk mund të dalim. As te dera e as në shitore nuk mund të dalim", ka treguar Kastrioti.

Megjithatë, protestë e madhe është paralajmëruar edhe në vendin ku ai momentalisht është duke qëndruar. "Normalisht që po frikësohemi sepse ne këtu nuk kemi as ambasadë. Sot (kompania) na i kanë sjellë pasaportat dhe nuk na kanë dhënë ndonjë lajm se çfarë do të bëjmë, vetëm na kanë thënë 'nesër e keni pushim'", ka treguar ai.

Një ndërprerje masive e internetit dhe valëve telefonike në shtet ka shtuar shqetësimin për këta shqiptarë nga Kosova. "Familiarët janë shqetësuar se dy ditë nuk kemi pasur internet, sepse e ka ndaluar Kazakistani, do të thotë nuk kemi pasur si t'i lajmërojmë", ka thënë Kastrioti. Interneti më 6 janar është rikthyer.

Vitet e fundit shumë shqiptarë nga Kosova kanë arritur të sigurojnë punë në Kazakistan kryesisht përmes kompanisë "Mabetex Group". Konkurse për vende të reja të punës vazhdimisht janë hapur,



kurse ai i fundit ishte në dhjetor 2021.

Në korrik të vitit 2020 kjo kompani kishte shpallur mbi 230 vende të reja të punës në Kazakistan, kryesisht në ndërtimtari.

Me gjithë përpjekjet e "Radios Evropa e Lirë", kompania "Mabetex" dhe përfaqësues të saj nuk u janë përgjigjur pyetjeve lidhur me numrin e punëtorëve kosovarë atje apo gjendjen e tyre sa i përket sigurisë.

Kastrioti, punëtori që merret me sisteme hidraulike, ka treguar se vetëm në një zonë të qytetit ku ai punon, me të punojnë edhe 300 shqiptarë të tjerë. Ai ka thënë se, përveç njoftimit për pushim, nuk kanë asnjë informacion tjetër lidhur me atë se çfarë do të ndodhë tutje me ta. "Aeroportet janë mbyllur. Ne po presim të qetësohet situata. Kompania, në fakt, nuk ka lajmëruar asgjë", ka thënë ai.

Deri më tani as Ministria e Punëve të Jashtme nuk ka ofruar informacione lidhur me atë sa qytetarë të Kosovës gjenden në Kazakistan aktualisht dhe si është gjendja e tyre.

"Mabetex Project Engineering" është një kompani globale e specializuar për ndërtim dhe ka filiale në 18 vende. Kompania ka selinë në Lugano të Zvicrës dhe ka të punësuar rreth 14 mijë punëtorë.

Vetëm në Kazakistan, sipas të

dhënave publike, kompania ka bërë ndërtimin e Rezidencës së Presidentit në Nur Sulltan, ndërtesa të ministrive dhe salla të koncerteve atje.

Ndërtime të tjera përfshijnë: Teatrin Nacional të Dramës Neo-Klasike, Teatrin e Operës dhe Baletit, Aeroportin në Nur Sulltan, ndërtesën e Ministrisë së Sportit dhe Turizmit në Kazakistan e të tjera.

Kastrioti, ndërkohë, tregon se është i shqetësuar për kolegët e shokët e tij që gjenden në qytete si Almati me më shumë trazira. Ai sidomos bashkëndien me familjet në Kosovë që përcjellin me shqetësim lajmet nga Kazakistani. "Duhet që kompania jonë, kur të kemi kësi lloj problemesh, t'i lajmërojmë familjet tona ose të bëjmë ndonjë postim. Më e pakta që mund të bëjmë", ka thënë Kastrioti.

## Çfarë po ndodh në Kazakistan?

Kazakistani po përjeton protestat më të këqija në rrugë që vendi ka parë që nga fitimi i pavarësisë tri dekada më parë. Shpërthimi i destabilitetit po shkakton shqetësim të madh në dy fqinjët e fuqishëm të Kazakistanit: Rusinë dhe Kinën. Vendi shet shumicën e eksporteve të naftës në Kinë dhe është një aleat kryesor strategjik i

Moskës. Një rritje e papritur e çmimit të karburantit të makinave në fillim të vitit shkaktoi protestat e para në një qytet të largët naftë në perëndim. Por, dhjetëra mijëra protestues që kanë dalë që atëherë në rrugë në shumë qytete, tani kanë në sy të gjithë qeverinë autoritare.

Presidenti Kassym-Jomart Tokayev fillimisht ka tentuar t'i qetësonte turmat duke shkarkuar të gjithë qeverinë. Por, në fund të ditës ai kishte ndryshuar qëndrim. Së pari, ai i ka përshkruar demonstruesit si terroristë, pastaj ai i ka bërë thirrje një aleance ushtarake të udhëhequr nga Rusia, Organizatës së Traktatit të Sigurisë Kolektive, për ndihmë në shtypjen e kryengritjes dhe CSTO ra dakord të dërgonte një numër të pacaktuar paqeruajtësish.

## Jeta e të pasurve të Kazakistanit

Policia e Kazakistanit ka thënë se disa protestues janë "eliminuar" gjatë natës në qytetin më të madh të shtetit, Almati, kur ata kanë tentuar të hyjnë nëpër ndërtesa administrative, ndërkohë janë përshkallëzuar trazirat kombëtare.

Nga pesë republikat e Azisë Qendrore që fituan pavarësinë pas shpërbërjes së Bashkimit

Sovjetik, Kazakistani deri më tani është më i madh dhe më i pasuri. Ai shtrihet në një territor me madhësinë e Evropës Perëndimore dhe ndodhet në majë të rezervave kolosale të naftës, gazit natyror, uraniumit dhe metaleve të çmuara.

Por, ndërsa pasuritë natyrore të Kazakistanit e kanë ndihmuar atë të kultivojë një klasë të mesme solide, si dhe një grup të konsiderueshëm manjatësh tepër të pasur, vështirësitë financiare janë të përhapura. Paga mesatare mujore kombëtare është pak më pak se 600 dollarë. Tubimi që shkaktoi krizën e fundit u zhvillua në qytetin perëndimor të naftës, Zhanaozen. Ka kohë që pakënaqësitë janë acaruar në zonë për shkak të ndjenjës se pasuritë energjetike të rajonit nuk janë shpërndarë në mënyrë të drejtë në mesin e popullsisë vendase. Në vitin 2011 policia qëllon për vdekje të paktën 15 persona në qytet të cilët po protestonin në mbështetje të punonjësve të naftës të pushuar nga puna pas një greve. Kur çmimet për gazin e lëngshëm të naftës, të cilin shumica e njerëzve në zonë e përdorin për t'i furnizuar makinat e tyre, u dyfishuan gjatë natës të shtunën, durimi u këput. Banorët në qytetet e afërta u bashkuan shpejt dhe brenda disa ditësh protesta të mëdha u përhapën në pjesën tjetër të vendit.

qeverisjen 4-vjeçare të Gjilanit është më e natyrshme dhe më e mira e mundshme. Ashtu qysh edhe do të duhej, ashtu qysh edhe është pritur, sot qenka zyrtarizuar marrëveshja për bashkëqeverisje në mes të LV-së dhe PDK-së në Gjilan. S'ka qysh më mirë dhe më natyrshëm sepse rotacioni i vërtetë i pushtetit nënkupton ardhjen e opozitës në qeverisje dhe ikjen në opozitë të atyre që e kanë qeverisur komunën deri tani. Çdo kombinim tjetër do të ishte

'me therë' dhe do të përcillej me një dozë të ankthit e të kompromiseve joparimore për lëshimet dhe gabimet nga mandatet e kaluara", ka shkruar Mustafa në llogarinë e vet në "Facebook". Sipas tij, gjatë qeverisjes këto subjekte politike duhet ta kenë për bazë interesin e qytetarëve. "Gjilani ka nevojë të kthehet në normalitet nga i cili ka ikur me vite të tëra. Secili nga këshilltarët e kuvendit të komunës dhe secili nga drejtorët e zyrtarët e lartë, deri te kryetari i

komunës, duhet ta kenë të qartë që prioriteti i parë dhe më i larti është komuna me qytetarët e familjet e saj e pastaj vjen në radhë interesi i subjekteve që e qeverisin komunën e në radhë të tretë interesi i menaxherëve dhe i zyrtarëve të këtyre subjekteve. Çdo prishje e rangimit të këtyre prioritetëve shkon, para së gjithash, në dëm të komunës e pastaj edhe të subjekteve në qeverisje", ka vlerësuar Mustafa, duke i uruar opozitës në këtë komunë të jetë plotësisht e

angazhuar, konstruktive dhe vetëkritike.

Afërsia në mes të këtyre dy partive është vërejtur në raundin e dytë të zgjedhjeve, i cili është mbajtur më 14 nëntor të vitit 2021. Në disa komuna këto parti kishin përkrahur kandidatët e njëra-tjetrës, por pa marrëveshje zyrtare. E njëjta gjë kishte ndodhur edhe në Gjilan, ku strukturat e PDK-së kishin përkrahur kandidatit e LV-së. Në raundin e dytë të zgjedhjeve lokale, kandidati i Lëvizjes

Vetëvendosje, Alban Hyseni, ka fituar garën për komunën e Gjilanit, duke e mposhtur kandidatit e LDK-së, Lutfi Haziri, i cili e kishte udhëhequr komunën për dy mandate radhazi. Një bashkëpunim në mes të këtyre dy partive është vërejtur edhe në komunën e Podujevës, e cila udhëhiqet nga Shpejtim Bulliqi i LV-së. Në fund të vitit të kaluar në këtë komunë kryesuesi i Kuvendit Komunal në Podujevë është zgjedhur nga radhët e PDK-së.



## Ministrja Nagavci: S'ka vend për greva në sektorin e arsimit

PRISHTINË, 6 JANAR - Ministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit (MASHTI), Arbërie Nagavci, ka thënë se shpreson se në këtë vit nxënësit të shënojnë rezultate të mira në testin PISA. Ajo ka treguar se pavarësisht prej ndikimeve të pandemisë në cilësinë në arsim, nuk e ka menduar tërheqjen nga ky test ndërkombëtar, i cili vlerëson aftësitë e nxënësve 15-vjeçarë në lexim, matematikë dhe shkencë.

Në një intervistë për "Kosovapress", ajo ka folur edhe për protestat dhe për grevat e paralajmëruara nga ana e SBASHK-ut. Sipas saj, nuk ka arsye të mbahen ato. "Është e qëndrueshme dhe e drejtë kërkesa që përfundimisht në Republikën e Kosovës të kemi një Ligj të Pagave i cili i rregullon dhe i adreson pabarazitë që ekzistojnë në mes të kategorive të ndryshme që punojnë në sektorin e publik. Por, nuk ka vend për greva e aq më pak për shantazhe e për kërcënime, sepse tashmë është duke u

punuar në këtë projektligj dhe besoj që në pranverë do ta kemi draftin e parë të projektligjit", ka deklaruar Nagavci.

Ajo ka thënë se pandemia ka thelluar vështirësitë e fëmijëve gjithandej në botë për arritjen e rezultateve, duke shtuar se këto ndikime janë evidente edhe në Kosovë. "Në Kosovë, përtej problemeve të shumta, ka pasur edhe vështirësi në implementimin e mësimit në distancë për arsye prej më të ndryshmeve. [...] Po shpresoj që puna që bëhet në shkolla dhe ngritja e vetëdijes e mësimeve pas diskutimeve të fundme që kanë ndodhur nga rezultatet e testit të fundit të PISA, ku nxënësit tanë kanë marrë pjesë dhe ku më të drejtë kanë pasur një diskutim të përgjithshëm të prindërve, të shoqërisë dhe një adresim të vëmendjes për nevojën e përmirësimit të cilësisë në mësime dhe në mësuesit. Shpresoj që të kemi rezultate më të mira sado që situata me pandeminë e ka vështirësuar punën në drejtim



të përmirësimit të cilësisë në arsim", ka thënë ajo.

Pas dy vjetëve të mësimit me skenarë të ndryshëm, gjysmëvjetori i parë i vitit shkollor 2021/2022 u realizua në skenarin A, ose me prani fizike në shkolla me orë mësimore të plota që kanë zgjatur 45 minuta.

Mirëpo ditët e fundit Kosova është përballur me rritje të numrit të rasteve me Covid pas paraqitjes së variantit

"Omicron" dhe në rast se përkeqësohet situata me pandeminë, rrezikohet që nxënësit t'i rikthehen mësimit online.

Në lidhje me këtë çështje Nagavci ka deklaruar se do t'i presin rekomandimet e institucioneve shëndetësore për të marrë ndonjë vendim që do të ndikonte në procesin mësimor. "Përtej shëndetit dhe rëndësisë së ruajtjes së shëndetit, natyrisht që uroj dhe

po punojmë që të kemi rezultate edhe në procesin e mësimit, që mësimi të zhvillohet me prani fizike. Por, sikurse edhe në të kaluarën, çdo vendim që e marrim do të jetë në koordinim të plotë me IKShPK-në, me ekspertët shëndetësorë dhe vendimmarrja do të bëhet sipas rekomandimeve, duke përcjellë situatën epidemiologjike, por edhe në konsultim të ngushtë edhe me drejtoritë e arsimit dhe me shkollat në përgjithësi. Pra, uroj që të kemi një situatë të mirë sa i përket shëndetit të përgjithshëm publik e kjo pastaj do të na lejojë një komoditet në lidhje me zhvillimin e mësimit me pjesëmarrje fizike", është shprehur ajo.

Nagavci ka vlerësuar se janë duke punuar në disa drejtime për ta përmirësuar cilësinë e arsimit në Kosovë, ku përmend investimet në infrastrukturën ligjore. Në këtë kontekst, ajo thotë se kanë finalizuar Ligjin për Agjencinë Kosovare të Akreditimit që i hap rrugë rikthimit të Kosovës në ENQA e në EQAR.

## Hamza kërkon mbështetje nga Gjermania dhe Izraeli për zhvillimin e Mitrovicës



MITROVICE, 6 JANAR (ER) - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, ka pritur të enjten në takim ambasadorin e Gjermanisë në Kosovë, Joern Rohde. Në këtë takim është biseduar për çështje të ndryshme, me theks të veçantë për nxitjen e zhvillimit ekonomik në qytetin e Mitrovicës.

Kryetari Hamza ka shprehur mirënjohjen e tij për mbështetjen e vazhdueshme të Republikës Federale Gjermane ndaj Republikës së Kosovës, ndërsa ambasadori Rohde e ka

falënderuar nikoqirin për mikpritjen që i është bërë gjatë vizitës së tij në Mitrovicë. Po të enjten Hamza është takuar edhe me një delegacion nga Izraeli, i kryesuar nga afaristët Damian Brikman, kryeshef ekzekutiv i Korporatës për Zhvillim dhe Investim të Izraelit në Kosovë (KIDIC) dhe Hilik Bar, ish-nënkryetar i Bashkisë së Jerusalemit. "Në këtë takim është diskutuar rreth mundësisë së bashkëpunimit të komunës së Mitrovicës me kompaninë 'KIDIC' në segmente të

caktuara të qeverisjes lokale, respektivisht për realizimin e disa projekteve të cilat do të hapnin vende të reja pune. Me këtë rast, kryetari Hamza ka falënderuar afaristët izraelitë për gatishmërinë e tyre që me projekte konkrete të ndihmohet zhvillimi ekonomik i qytetit. Në fund të takimit të dyja palët janë marrë vesh për thellimin e bashkëpunimit për realizimin e projekteve të cilat do të siguronin mirëqenie më të mirë për të gjithë qytetarët e Mitrovicës", ka njoftuar komuna e Mitrovicës.

## Ramosaj: Deçani pati një vit të vështirë

DEÇAN, 6 JANAR - Kryetari i komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka deklaruar se viti 2021 ka qenë sfidues për qytetarët e kësaj komune. Ai ka thënë se helmimi i qytetarëve nga uji i pijshëm, vrasja e trefishtë dhe vdekjet e njerëzve për shkak të Covid-19, janë arsye pse viti i kaluar ka qenë i vështirë për deçanasit.

Ramosaj ka thënë se pret nga organet e drejtësisë që ta zbardhin rastin e helmimit me ujë të pijshëm të shumë qytetarëve të kësaj komune, si dhe rastin e fundit ku tre qytetarë janë vrarë në mënyrë mizore. "Ka qenë vit sfidues në disa tema. Ka qenë sfidues për kreyt botën dhe

sidomos për shtetin tonë. Ajo çfarë ka ndodhur me ujin e pijshëm në Deçan ka kohë që po e bëjmë një luftë tepër të madhe që t'i marrim këto kompetenca dhe ta kemi në kompetencë menaxhimin e ujit të pijshëm në komunën e Deçanit. E dimë qysh keqmenaxhohet dhe e dimë sa të pazotë janë për menaxhim të ujit të pijshëm në një qytet ku ka resurse tepër të mëdha ujore. Unë shpresoj që organet përgjegjëse, qoftë të hetuesisë, prokuroria, gjykata, do ta çojnë deri në fund temën e helmimit të ujit të pijshëm. Nuk ka qenë vit i lehtë, sidomos edhe me rastet e vështira që i kemi pasur, sepse një pjesë të njerëzve në këtë qytet i ka

marrë pandemia dhe deri te rasti i fundit ku e patëm vrasjen e trefishtë. Unë uroj që hetuesia, prokuroria, të mos lënë alternativë pa e studiuar që t'i japin epilog përfundimtar kësaj ngjarjeje", ka thënë ai për "Kosovapress".

Më tutje, kryetari i Deçanit ka shprehur optimizëm që gjatë këtij viti do të përfundojë asfaltimi i rrugës Deçan - Plavë pavarësisht prej përplasjeve që janë zhvilluar me përfaqësuesit e Manastirit të Deçanit gjatë vitit të kaluar kur edhe u ndaluan punimet. Për një gjë të tillë Ramosaj ka thënë se pret edhe mbështetjen e nivelit qendror, në të kundërtën thotë se nuk i bëhet nder vendit.





# Rama: I rritim pagat e mjekëve 40 për qind nëse s'ka fatkeqësi natyrore

TIRANË, 6 JANAR - Shqipëria ka tani një spital të ri për fëmijët. Kryeministri Edi Rama ka marrë pjesë në inaugurimin e Pediatrisë. Ai ka thënë se brenda katërvjeçarit të tretë Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" do të jetë më modernia në rajon. Por edhe këtë ambicie kreu i qeverisë e ka thënë me gjysmë zëri. "Çdo parashikim ta bëjmë me rezervë, se të vjen pa prituri e pa kuptuar në ekuacion një tërmet, larg qoftë, ndonjë pandemi, përmbytje apo dreqi vetë. Por, sipas të gjitha parashikimeve, brenda këtij mandati QSUT kthehet në kompleksin më të madh dhe më modern të rajonit, jo vetëm të Shqipërisë", ka thënë Rama. Bluzave të bardha vazhdimisht u është premtuar rritje e pagave, aq më shumë në dy vjetët e fundit pasi kanë qenë në frontin e parë përballë Covid-19. Në këtë kontekst, Rama ka thënë se do të rriten pagat e mjekëve nëse nuk do të ketë ndonjë

fatkeqësi natyrore. "Rritja e pagës do të bëhet vit pas viti. Ambicia është që të shkojmë në +40 për qind brenda mandatit, gjithmonë duke u lutur që ato që na i sjell koha në formën e fatkeqësive natyrore të na i kursejë kush i vendos këto gjëra dhe që nuk e njohim. Prezumojmë që, mbase, edhe na dëgjon në mënyrë që në këto katër vjet t'i bëjmë ato që kemi planifikuar", është shprehur kryeministri Rama. Për mos ta lënë gjithçka në dorë të Zotit, qeveria ka parashikuar një bonus për mjekët e suksesshëm. "Është një sistem i tërë pikëzimi që sjell te mjeku të ardhura më të larta sesa kolegu që vazhdon të paguhet me pagën bazë, por për shkak se ka një performancë mesatare nuk merr dot sa merr kolegu në krah", është shprehur Rama. Godina e Pediatrisë është vijim i investimeve të nisura në QSUT, si Spitali i Sëmundjeve të Brendshme apo Kardiokirurgjia.



## Qeveria sërish injoron komunat për pandeminë

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 JANAR - Qeveria e Republikës së Kosovës përsëri ka injoruar komunat e Kosovës sa iu përket konsultave rreth situatës me pandeminë Covid-19.

Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) ka bërë me dije se sërish nuk është ftuar si anëtar në Komitetin Kudër Covidit. Njëherë më parë, AKK-ja ka ftuar Qeverinë e Kosovës të bashkëpunojë ngushtë dhe sinqertë me të gjitha komunat. "Kjo tregon se AKK-ja u përjashtua edhe një herë nga ky komitet, i cili nga komunat cilësohet si mekanizëm shumë i rëndësishëm në luftën për parandalimin e përhapjes së Covid-19. Komunat e Republikës së Kosovës edhe një herë ftojnë Qeverinë e Kosovës të bashkëpunojë ngushtë dhe sinqertë sepse numri i rasteve me Covid-19 është në rritje dhe

një injorim i tillë i komunave është i pajustificueshëm. Komunat janë të qytetarëve të saj dhe e kanë kryetarin që është zgjedhur me votë të drejtpërdrejtë, prandaj në asnjë mënyrë nuk bën të injorohen si të tilla", është thënë në reagimin e AKK-së. Sipas AAK-së, qeveria duhet të jetë konstruktive me komunat në luftën kundër pandemisë. "Jeta zhvillohet në komuna. Kryetarët e komunave që nga fillimi i pandemisë kanë qenë në ballë të luftës për parandalimin e përhapjes së Covid-19 andaj kërkojmë që të bashkëpunoni ngushtë me të gjitha komunat dhe me AKK-në si përfaqësues i komunave në mënyrë që situata me Covid të përballohet më lehtë. Si gjithnjë, edhe këtë herë komunat kërkojnë qasje konstruktive nga Qeveria e Republikës së Kosovës kundruall nivelit lokal. AKK-ja është rikthyer në këtë komitet me vendim të ish-ministrit Arben Vitia", është në reagimin e AKK-së.

## Vazhdon rritja e rasteve të reja me Covid

PRISHTINË, 6 JANAR (ER) - Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit janë paraqitur 152 raste të reja me Covid. Po ashtu, kjo ministri ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë dhënë 4 102 doza të vaksinës

kundër koronavirusit. "Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 683 758 doza të vaksinës. Deri më sot 786 859 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Nga 5 474 testime, 152 qytetarë kanë rezultuar pozitiv me virusin

Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit, nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Sot janë shënuar 20 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 158 102. Në total numri i rasteve aktive është 872", ka njoftuar MSh-ja.





## Dogana në vitin 2021 grumbulloi 1.37 miliard euro

PRISHTINË, 6 JANAR - 1.37 miliard euro janë të hyrat vjetore për vitin 2021 nga Dogana e Kosovës. Lajmin e ka bërë me dije, në një konferencë për medie, drejtori i përgjithshëm i Doganës, Agron Llugaliu. Ai ka thënë se ky vit ka qenë sfidues për ta por, pavarësisht prej kësaj gjendje, me një punë ekipore kanë arritur t'i tejkalojnë përditshmëritë. "Viti që lamë pas ka qenë një vit i brishtë për shkak të sfidave, mirëpo kemi pasur mundësi t'i arrijmë objektivat. Një prej sfidave ka qenë rritja e vëllimit të të hyrave, performanca ekonomike rreth 10 për qind gjithashtu ka lehtësuar punën. Dogana ka pasur një strategji për ofrimin e kushteve për të gjithë, reformë të proceseve kyçe për evazion fiskal dhe kemi pasur një bashkëpunim me biznese dhe qytetarë. Të hyrat nga Dogana e Kosovës janë 1.37 miliard euro apo 320 milionë më shumë se në vitin e kaluar. Kemi pasur të hyra

edhe 16 për qind më shumë se në vitin 2019. Kjo është bërë pa ndryshime në norma fiskale", ka thënë ai. Më tutje, ai ka thënë se edhe importi ka shënuar rritje krahasuar me vitet paraprake, duke arritur shifrën e 4.6 miliardë eurove. "Ajo që kemi vërejtur se ka pasur të hyra më shumë se 30 për qind, ne kemi vërejtur se ka rënie të ankesave të bizneseve dhe na tregon se ka një gatishmëri për t'i paguar taksat. Te importi kemi pasur 4.6 miliardë euro, krahasuar me vitet paraprake ka pasur 3.5 miliardë euro", ka deklaruar Llugaliu. Ndërsa ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka thënë se si qeveri janë të kënaqur me të hyrat nga Dogana e Kosovës. Murati ka thënë se një rekord tjetër që është shënuar në vitin 2021 është ai në eksport. "Si Ministri e Financave, por edhe si qeveri, jemi të kënaqur me



performancën sa iu përket të hyrave. Kontribut të madh ka dhënë Dogana e Kosovës. Është shënuar një rekord i të hyrave. Në përgjithësi mund të thuhet se

të hyrat janë të jashtëzakonshme. Kemi një rekord edhe të eksportit me mbi 700 milionë euro. Ka një rekord edhe të luftës ndaj kontrabandës

dhe nuk ka lëshim nga shteti në këtë aspekt. E përgëzoj stafin e Doganës për këtë punë. Shpresoj se sukcesi të vazhdojë edhe këtë vit", ka thënë Murati.

## Bizneset në Kosovë përballen me probleme për shkak të krizës energjetike

PRISHTINË, 6 JANAR - Abedin Salihu drejton një kompani me rreth 220 punëtorë në fushën e minierave e mineraleve, ndërtimit, prodhimit të betonit dhe pjesëve të mermerit. Muajt e fundit ai ka thënë se ndërprerjet e energjisë elektrike kanë lënë pas vetes pasoja në veprimtarinë e tij. "Arsyet kryesore të kësaj ndërprerjeje janë pikërisht se në linjën ku ne posedojmë guroren tani tensioni i rrymës është i ulët dhe nga i cili nuk mund t'i aktivizojmë makineritë sepse pastaj ato digjen për shkak të aparaturave dhe sistemin që kanë. Ato duan rrymë stabile, prandaj e kemi ndërprerë aktivitetin dhe kemi çuar disa prej punëtorëve në pushim, por me pagesë, sepse ata janë punëtorë profesionalë e nuk mund t'i largojmë e pastaj t'i kthejmë e që për ne kanë kosto dhe është një sfidë që paguajmë e nuk marrim



asgjë", ka thënë ai për "VOA". Ai ka thënë se puna me gjeneratorë është e pamundshme për shkak se makineritë e mëdha kërkojnë sasi të mëdha të energjisë elektrike dhe, si të tilla, shpenzojnë shumë derivate të

naftës. "Minimumi i dëmeve ditore, sipas një parallogarie që është bërë nga stafi i financave, është mbi dy mijë euro", ka thënë ai. Salihu ka thënë se këto ndërprerje e kanë çrregulluar biznesin dhe shumë kolegë të

tij po mendojnë të investojnë jashtë vendit për shkak të pasigurisë dhe dëmeve të marrëveshjeve për eksport. Javët e fundit Kosova është duke u përballur me përkeqësim të situatës me energji elektrike, ndërsa është

detyruar të importojë rreth 40 për qind të energjisë elektrike. Qeveria e ka shpallur gjendjen emergjente për ta tejkualuar krizën energjetike. Drejtori i Odës së Afarizmit të Kosovës, Skënder Krasniqi, ka thënë se institucionet e Kosovës është dashur të përgatiten shumë më herët për gjendjen aktuale energjetike. Krasniqi ka thënë se oraret e shkurtimeve duhet të jenë të rregullta dhe të bëhen me paralajmërim për hir të bizneseve. "Ndalja e rrymës i bënë dy dëme: ndal kapacitetet prodhuese, por dhe biznesit i shkaktohen dëme sepse punëtorin duhet ta paguajë për atë kohë sa ka mungesë, pastaj jemi përballur edhe me një problem tjetër që ka qenë ndalja e rrymës trefazore. Do të thotë ky ka qenë një problem i madh për të cilën e kemi njoftuar edhe KEDS-in edhe qeverinë sepse kjo ndalje ka qenë e vetëdijshme", ka thënë ai.

## Murati për ndalimin e kriptovalutave: Ka qenë e nevojshme të kufizohet prodhimi i tyre

PRISHTINË, 6 JANAR (ER) - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka thënë se vendimi për ndalimin e prodhimit të kriptovalutave është i duhur, marrë parasysh gjendjen me energji. Ai gjatë prezantimit të rezultateve vjetore në Doganën e Kosovës ka thënë se është e nevojshme që të merret ky vendim në mënyrë

që të kursehet xhepi i qytetarëve. "Do të ishte shumë e padrejtë që ne si shtet të subvencionojmë fitimin e dikujt në kurriz të qytetarëve të tjerë, prandaj ka qenë e nevojshme që të merret ky vendim që të kufizohet përkohësisht mihja apo prodhimi i kriptovalutave në mënyrë që t'i kursejmë xhepat

e qytetarëve. Kjo ka qenë arsyeja", ka deklaruar ai. Gjatë kësaj jave Qeveria e Kosovës ka njoftuar se institucionet kompetente do të angazhohen që ta ndalojnë prodhimin e kriptovalutave, pasi dyshohet se pajisjet me të cilat prodhohen ato shkaktojnë konsum të lartë të energjisë elektrike.





# Kush e fitoi Luftën e Ftohtë?



Nga Daniel MCCARTHY  
"The Spectator"

26 dhjetorin e 30 viteve më parë, ndodhi ajo që dukej e pamundur deri në atë moment. Një nga shtetet më brutale dhe të përgjakshme të shekullit XX u shpërbë pa dhunë. Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike (BRSS), ishte shembur de facto disa muaj më parë, kur rusët dolën në rrugë për të sfiduar forcat komuniste të vijës së ashpër, që kishin kryer një grusht shteti kundër qeverisë së Mikhail Gorbachev-i të pafuqishëm.

Ai reagim popullor kundër grushtit të shtetit ishte në vetvete kryesisht paqësor: ushtarët që u thirrën të mbrojnë puçistët refuzuan të qëllonin mbi bashkatdhetarët e tyre. Thuhet shpesh se Lufta e Ftohtë mori fund me rrëzimin e Murit të Berlinit në vitin 1989.

Po sikur gjërat të kishin shkuar ndryshe në Moskë 2 vjet më vonë, beteja mund të kishte rifilluar. Kjo pasi shtetet komuniste mbijetojnë ende në Amerikën Latine dhe Azinë Lindore, duke mos harruar kombin më të populluar në botë.

Perëndimi kishte dikur besim se Republika Popullore e Kinës do të pasonte së shpejti Bashkimin Sovjetik në koshin e plehrave të historisë. Por në triumfin e lirisë mbi tiraninë nuk ka asgjë të pashmangshme. Që të ndodhë ai

triumf, kërkon përpjekje të mëdha njerëzore. Rusët fituan në Luftën e Ftohtë. Po kështu bënë çekët, polakët, gjermanët, hungarezët, ukrainasit dhe të gjithë popujt që u çliruan nga komunizmi. Por Luftën e Ftohtë e fitoi edhe nacionalizmi: shtetet kombëtare të robëruara e refuzuan imperializmin sovjetik, dhe vetë rusët rrëzuan një parti, e cila sundonte në emër të një klase, dhe jo të popullit rus.

Besimi fetar fitoi edhe kundër ateizmit shtrëngues. Dhe prona private dominoi kundër socializmit. E megjithatë, Lufta e Ftohtë pati fitues të tjerë, dhe një humbës përveç komunizmit. Një nga fitueset ishte Partia Komuniste Kineze.

Duke e lidhur Kinën me sistemin kapitalist ndërkombëtar të udhëhequr nga perëndimi, Kina përfitoi zhvillimin që do të garantonte pushtetin e PKK për dekada. Natyrisht komunizmi kinez, nuk e fitoi Luftën e Ftohtë në kuptimin e ndihmës së drejtpërdrejtë për të kapërcyer komunizmin sovjetik.

Por pasardhësit e Maos dolën nga konflikti midis Moskës dhe Uashingtonit, duke pasur një pozitë më të favorshme në rendin botëror. Ndërkohë intelektualët perëndimorë, e vlerësuan fundin e Luftës së Ftohtë jo për këmbënguljen e besnikërisë ndaj kombit dhe besimit, por për tërheqjen e supozuar të

papërmbyajtshme të konkurrentit ideologjik të komunizmit: demokracisë liberale.

Liberalizmi ishte besimi i vërtetë universal i njerëzimit, dhe ai mbështetej shumë nga intelektualë perëndimorë. Demokracia liberale e konceptuar nga profesorët, ekspertët dhe politikë-bërësit nënkuptonte më shumë se sa vetëm liritë themelore të qytetarëve brenda një shteti kombëtar sovran dhe demokratik.

Ajo do të nënkuptonte një botë të integruar përmes institucioneve ndërkombëtare dhe marrëveshje të mëdha tregtare shumëpalëshe: një botë, në të cilën bashkëpunimi me vizionin udhëheqës të elitës perëndimore, përbënte aderimin në pararojën e historisë, madje edhe për petro-despotizmat e Lindjes së Mesme që ishin gjëja më e largët në raport me atë që është "liberale" apo "demokratike".

Ashtu siç një komunist i mirë nuk duhet të jetë në të vërtetë një punëtor, një liberal demokrat nuk duhet të ishte një James Madison. Ai ose ajo thjesht duhet të pajtohej me çdo gjë që kërkonte klika në pushtet. Patriotizmi dhe feja ishin të domosdoshme në përballjen e Perëndimit me komunizmin, por ato ishin ndër humbësit e Luftës së Ftohtë.

Partitë konservatore dhe institucionet civile, nga të cilat mund të pritej që të mbështesnin

një komb ose një besim nga fundi i viteve 1980, ishin bashkuar aq shumë me ideologjinë e demokracisë liberale, sa që ishin çrënjësuar në aspektin kulturor. Revistat dhe grupimet e mendimit me prijje të djathta, sidomos ato në SHBA hodhën poshtë idenë e interesave specifike kombëtare, në favor të të drejtave universale dhe logjikës së tregjeve mbarëbotërore. Teoria ishte: E gjithë bota do që të jetë Amerikë, dhe amerikanët amerikanë nuk ishin më të mirë se amerikanët jo-amerikanë.

Përkundrazi, amerikanët në frymë duhet të preferojnë gjithmonë ndaj qytetari amerikan thjesht në letra. Pikërisht në momentin kur besnikëria tradicionale njerëzore po e zhdukte ideologjinë komuniste në sferën sovjetike, një element i ri ideologjik i fuqishëm po e zhbënte ndjenjën e solidaritetit dhe kombësisë së amerikanëve.

Të paktën kështu ndodhi mes klasës së mendimtarëve dhe politikanëve që duhet të kishin artikulluar dhe avancuar interesat e "Main Street". Në vend të kësaj ata promovuan globalizmin. Megjithatë, demokracia liberale ka rezultuar të jetë edhe më e vështirë për t'u shenjtëruar dhe eksportuar sesa komunizmi.

Ajo kundërshtohet aktualisht nga Polonia dhe Hungaria, nga Rusia dhe Kina e pasuruar falë kapitalizmit. Por jo nga Afganistani pas 20 vitesh

bombash dhe parash amerikane. Polonia dhe Hungaria janë vende të lira, por jo liberal-demokratike. Rusia është autoritare, Kina është një despotizëm komunist, ndërsa talebanët po e sundojnë Afganistanin me një përzierje të tribalizmit, islamizmit dhe banditizmit të hapur. Këto vende ndryshojnë rrënjësisht nga njëri-tjetri, por që të gjitha janë vende ku janë shkatërruar ëndrrat e perëndimorëve të iluminuar, dhe ku dëshira perëndimore për konformitet ideologjik është një pengesë për ndryshim.

Ideologjia nuk është një zëvendësues i besnikërisë lokale. Perandoria Sovjetike u zhduk pikërisht për këtë arsye. Liberalizmi është në rënie edhe në Perëndim, për shkak se udhëheqësit tanë nuk mund ta pranojnë se besimi i tyre është një bazë e pamjaftueshme për komunitetin dhe një mënyrë jetese e përbashkët.

Në një farë kuptimi, konservatorizmi e fitoi Luftën e Ftohtë, pasi forcat që ruanin kombet dominuar kundër të gjithë fuqisë jo të shenjtë të komunizmit sovjetik. Por konservatorizmi humbi paqen në Perëndim. Nëse forcat që ruajnë kombet nuk e rimarrin veten shpejt, ne do ta gjejmë veten duke mbërritur jo në fund të historisë globale, por në fund të historisë sonë.



Adri: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJOËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

# Hasani rikthehet te Shkëndija: Rikthehem që ta sjell titullin kampion

Reprezentuesi i Maqedonisë së Veriut, Ferhan Hasani, pas tre vjetësh e gjysmë, rikthehet për ta djersitur fanellën kuqezi. “Në vitin 2011 së bashku e fituam titullin kampion i Maqedonisë së Veriut dhe dëshira ime është ta përmbyll përsëri si kampion me Shkëndijën, bashkë me Ballistët dhe Tetovën”, ka thënë Hasani



**TETOVË, 6 JANAR** - Futbollisti i njohur Ferhan Hasani është rikthyer edhe zyrtarisht te KF Shkëndija. Klubi nga Tetova ka njoftuar se ka arritur marrëveshje për rikthimin e Hasanit duke bërë me dije se ai ka nënshkruar një kontratë prej dy vjetësh e gjysmë. “Hasani ka nënshkruar kontratë me kohëzgjatje prej dy vjetësh e gjysmë. Klubi me këtë lëvizje sensacionale bën përforsimin e tretë të kuqezinjve në këtë afat kalimtar të janarit, me çka vijon ndërtimi i skuadrës së re e cila pritet të hapë një kapitull të ri në sukseset e radhës së Shkëndijës”, thuhet në njoftimin e skuadrës shqiptare.

Hasani në skuadrën kuqezi rikthehet pas tre vjetësh e gjysmë, ndërsa brenda kësaj periudhe ishte pjesë e ekipit të Al-Raed nga Arabia Saudite, HJK

Helsinki nga Finlanda, ndërsa së fundmi luajti për ekipin e Partizanit nga Tirana. Po ashtu, verën e shkuar Ferhan Hasani ishte pjesë e përfaqësueses së Maqedonisë së Veriut në Kampionatin Evropian të Futbollit “Euro 2020”.

Ferhan Hasani në të kaluarën me fanellën e Shkëndijës ka fituar pesë trofe, dy herë titullin e kampionit të Maqedonisë së Veriut, dy trofe të Kupës dhe një trofe të Superkupës, ndërsa ishte ndër lojtarët kryesorë në sukseset e Shkëndijës në garat evropiane kur skuadra për tre vjet radhazi luajti në ndeshjet “play-off” të UEFA Europa League. Ndërkaq, me ekipin HJK Helsinki, Ferhan Hasani në vitin 2020 fitoi dy trofe, titullin e kampionit dhe Kupën e Finlandës. “Në vitin 2011 së bashku e fituam titullin kampion i Maqedonisë së Veriut. Dëshira

ime është që ta përmbyll përsëri si kampion me Shkëndijën, bashkë me Ballistët dhe Tetovën”, ka thënë Hasani. “Jam tepër i gëzuar që nënshkruaj me Shkëndijën, me klubin ku jam rritur dhe që është klubi im i zemrës. Jo vetëm që në të kaluarën kam qenë pjesë e Shkëndijës dhe kemi fituar shumë tituj së bashku, por sot rikthehem që ta ndihmoj skuadrën për fitimin e titullit kampion dhe në sukseset e radhës në garat evropiane. Besoj se rikthehem në momentin e duhur. Gjatë periudhës së kaluar trevjeçare që nuk isha pjesë e Shkëndijës kam fituar shumë përvojë, dhe këto përvoja të reja më kanë bërë edhe më të fortë. Pres që sa më parë të fillojë sezoni pranveror dhe të filloj të luaj me fanellën e Shkëndijës”, ka shtuar Hasani.

## SHKURT

### Ndahet nga jeta presidenti i Elbasanit, Arben Laze

Futbolli shqiptar ka humbur mbrëmjen e djeshme një nga kontribuuesit e tij më të mëdhenj, Arben Laze, presidenti i Elbasanit, u nda nga jeta pas problemeve në zemër. Një humbje e madhe kjo për të gjithë komunitetin e futbollit në vend duke kujtuar se nën drejtimin e tij Elbasani arriti ta fitojë titullin kampion të dytë në historinë e klubit në sezonin 2005-2006. Homazhet në nderim të Arben Lazes do të zhvillohen ditën e sotme, e enjte, 6 janar, nga ora 12:00-14:00 në “Elbasan Arena”.

### Në fundjavë do të mbahet FIBA SCOD Klinika

Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) ka njoftuar se në fundjavë (8-9 janar) do të mbahet FIBA SCOD Klinika për gjyqtarët e basketbollit. Të shtunën do të ligjërojnë instruktori i gjyqtarëve të FIBA-s, Gjorgji Piperkov, FIBA instruktori nacional i FBK-së, Faton Kurshumlija, prof. Ridvan Ekmekci dhe në ZOOM Online, menaxheri i Departamentit të Gjyqtarëve të FIBA-s, Davorin Nakiq. Ndërkohë të dielën në orën 11:00 në zyrat e FBK-së do të organizohen testimet për gjyqtarët perspektivë nga ana e përgatitjes mentale. Pjesëmarrja është e obliguar për të gjithë gjyqtarët.

### Empoli kërkon 12 milionë euro për Bajramin

Nedim Bajrami është kthyer në lojtarin e preferuar të disa skuadrave në Serinë A. Paraqitjet e tij me skuadrën e Empolit kanë rënë në sytë e drejtuesve të skuadrave italiane të cilat kanë shprehur hapur edhe pëlqimin që kanë për futbollistin e kombëtares shqiptare. Sassuolo dhe Cagliari janë dy nga ekipet të cilat kërkojnë të përfitojnë shërbimet e Bajramit, por nuk do të jetë aspak e lehtë përballë një Empoli që kërkon të mos lëshojë një nga xhevahirët e skuadrës. Përballë këtyre kërkesave për 22-vjeçarin, Empoli ka menduar t'i vendosë çmim Bajramit, teksa e vlerëson këtë të fundit me shifrën 12 milionë euro, shifër kjo jo e vogël për ekipe si Sassuolo dhe Cagliari.

### Genoa interesohet për Veton Berishën

Genoa po shikon mundësinë e transferimit të sulmuesit nga Kosova, Veton Berisha, i cili po shkëlqen me Vikingun në Norvegji. Berisha ka shënuar plot 22 gola në 27 ndeshje të ligës në sezonin që ka përfunduar tashmë në Superligën e Norvegjisë. Ai u shpërblye me një vend në ekipin kombëtar të Norvegjisë nga përzgjedhësi Stale Solbakken për arritjet e tij. Sulmuesi nga Kosova, i cili është edhe vëllai i reprezentuesit Valon Berisha, ka kontratë me Vikingun deri në vitin 2024, por shpejt mund të ndryshojë ambient. Kubi i Serisë A thuhet se ka shikuar se sa mund të kushtojë blerja e golashënuesit më të mirë të Viking dhe cilat janë kushtet e tij për pagë. Genoa, klub që udhëhiqet nga legjenda Andriy Shevchenko, ka pasur vështirësi në Serinë A këtë sezon dhe është në pozitën e 18 pas 19 ndeshjeve të luajtura, duke rrezikuar rënien nga kategoria.



## Vendimi final për Djokoviçin merret të hënën

MELBURN, 6 JANAR - Leja e posaçme që kishte siguruar nga organizatorët e Australian Open nuk ka asnjë efekt. Novak Djokoviç nuk është lejuar të futet në Australi, pasi tenisti serb nuk është i vaksinuar. Kjo çështje kaloi kufijtë sportivë duke u kthyer në një çështje politike, solli një reagim të

madh ku, si gjithnjë në të tilla raste, në Serbi kthehet në çështje qeveritare, nga presidenti Vuçiç e deri te Ministria e Sporteve, të gjithë nxituan duke reaguar dhe kërkuar llogari për këtë vendim që nuk e lejon tenistin të marrë pjesë në grand slemën e parë për këtë vit. Aktualisht

Djokoviç ndodhet në Melburn dhe aty do të qëndrojë deri në fundjavë pasi përfaqësues të tenistit kanë apeluar vendimin e qeverisë australiane për të mos e lejuar të futet në vendin e tyre, por kërkojnë që të kthehet në Serbi. Djokoviç qëndroi për rreth tetë orë në aeroport ku iu nënshtrua një kontrolli të

imtësishëm dhe dokumentacioni që ai kishte, së bashku me lejen speciale, nuk ishte i mjaftueshëm, i rregullt, për t'i lejuar atij futjen në Australi. Në këtë pikë kanë hyrë në skenë avokatët e Djokoviçit që kanë apeluar këtë vendim, ndërsa përgjigja përfundimtare do të jepet të hënën, nëse do të



mund të futet në Australi apo jo. Kujtojmë që Australian Open nis më 17 janar.

## Haalandi kushton 300 milionë euro

DORTMUND, 6 JANAR - Skuadra që dëshiron transferimin e sulmuesit Erling Haaland duhet të planifikojë të harxhojë 300 milionë euro. Sipas së përditshmes franceze "L'Equipe", secili që e transferon sulmuesin e Borussia Dortmundit duhet të planifikojë të harxhojë 300 milionë euro. Në fundin e sezonit, klauzola me vlerë 75 milionë euro do të aktivizohet dhe me kontratën që i skadon më 2024, drejtori gjeneral i Dortmundit, Hans-Joachim Vatzke, i ka dhënë ultimatum lojtarit të bëjë të qartë të ardhmen deri në muajin shkurt. PSG-ja është një ndër kandidatet për të nënshkruar me sulmuesin norvegjez, pasi Kylian Mbappe pritet të largohet në verë, por për



ta bërë atë transferim, duhet të ketë buxhetin prej 300 milionë eurosh. 75 milionë euro do të kushtojë klauzola e lirimt, 20 milionë euro komisioni për agjentin Mino Raiola dhe babanë e Haalandit, gjithashtu edhe pagë

prej 30-35 milionë eurosh për Haalandin në kontratë gjashtëvjeçare. Haalandi ka shënuar 76 gola në 79 ndeshje për Dortmundin. Nëse i shohim statistikën, i bie një gol për çdo 81 minuta në të gjitha garat.

## Duranti mban Brooklynin në krye, zhgënjejnë Milwaukee e Golden State

MILWAUKEE, 6 JANAR - Skuadra kampione e Milwaukee Bucksit pësoi humbjen e dytë radhazi në NBA, teksa u mposht me rezultat 117-111 nga Toronto. Si kam më 33 pikë ishte më i miri në parket për kanadezët, duke i bërë të



pavlefshme 25 pikë e Middletonit për Bucksin (nuk luajti Antetokounmpo). Humbet edhe Golden State, që u mund me rezultat 99-82 nga Dallasi. Curry realizoi vetëm 14 pikë, ndërsa për

vendasit u dallua Doniqi me 26 pikë. Pa probleme fiton skuadra e Brooklynit, që falë 39 pikëve të Durantit, mundi 129-121 Indianan, duke qëndruar në krye të renditjes në Lindje.

### REZULTATET

Charlotte - Detroit	140-111
Orlando - Philadelphia	106-116
Washington - Houston	111-114
Boston - San Antonio	97-99
Dallas - Golden State	99-82
Indiana - Brooklyn	121-129
Milwaukee - Toronto	111-117
Minnesota - Oklahoma	98-90
Denver - Utah Jazz	109-115
Portland - Miami	109-115
Sacramento - Atlanta	102-108

### SHKURT

#### Guardiola infektohet me Covid-19

Trajneri i Manchester Cityt, Pep Guardiola, ka rezultuar pozitiv me Covid-19. Trajneri spanjoll është personi i fundit që ka dalë pozitiv me koronavirus, ndërsa janë 21 raste pozitive në skuadër. City përmes një komunikate zyrtare konfirmoi se 14 pjesëtarë janë pozitivë me Covid-19, ndërsa edhe shtatë lojtarë janë të prekur. "Pep Guardiola do të mungojë në ndeshjen e nesërme për FA Cup ndaj Swindon Townit pasi doli pozitiv me Covid-19", thuhet në njoftimin e Cityt.

#### 17 lojtarë janë të pakënaqur në United

Manchester Unitedi po përballet me një situatë aspak të këndshme, pasi një numër i madh i futbollistëve kanë pakënaqësi. Mediumi "Daily Mail" raporton se janë plot 17 futbollistë që janë të pakënaqur në "Old Trafford". Paul Pogba, Edinson Cavani, Jesse Lingard, Dean Henderson e Donny van de Beek janë në mesin e lojtarëve që mund të largohen, kurse Eric Bailly, Anthony Martial e Nemanja Matiq gjithashtu po e konsiderojnë mundësinë e largimit. "Dajve të Kuq" nuk po u ecin punët mirë as këtë sezon dhe ndryshimet në fund të sezonit janë të domosdoshme. Nuk dihet nëse nga ky klub gjatë verës që vjen do të largohet edhe Cristiano Ronaldo.

#### Këta gjashtë futbollistë do të largohen nga PSG-ja

Skuadra e Paris Saint Germainit po planifikon largimin e disa futbollistëve në këtë afat kalimtar. Sipas raportimeve të medieve franceze, PSG-ja do të nxjerrë në shitje gjashtë futbollistë. Në krye të listës së largimeve është sulmuesi Mauro Icardi, i cili nuk po arrin të gjejë hapësirë për faktin se në klub janë edhe Mbappe, Messi dhe Neymar. Futbollistët e tjerë që pritet të largohen janë edhe Paredes, Rico, Kurzawa, Kehrer e Diallo.

#### Legjenda e Barcelonës: Messi mund të largohet në qershor

Lojtari legjendar i Barcelonës, Lobo Carrasco dhe bashkëpunëtor i rregullt i "El Chiringuito", ka hedhur një bombë në programin MEGA. "Nëse ai fiton, ai mund të qëndrojë edhe një vit. Nëse PSG-ja nuk fiton, Messi mund të largohet. Pesë muajt e ardhshëm do të jenë vendimtarë. Nëse ai nuk fiton Ligën e Kampionëve, mendoj se ai mund ta detyrojë largimin", ka thënë ai. Kjo nuk është hera e parë ku e ardhmja e Messit te PSG-ja vihet në dyshim pas vetëm një sezoni, pasi MLS është një destinacion që gjithmonë ka qenë tërheqës për argjentinasin.

## Joshua: Po ndryshoj për t'i rimarr titujt

Boksieri britanik Anthony Joshua po stërvitet në Dubai me kampionin e botës në peshën "cruiserweight", patriotin e tij Lawrence Okolie. Të hënën Joshua po stërvitej me Flyd

Mayweather, ndërsa tani ka gjetur një tjetër partner për ta ndarë ringun. Siç dihet, Joshua do të duelojë në pranverën e këtij viti ndaj ukrainasit Oleksandr Usyk, një revansh pas sfidës së

zhvilluar vjet në shtator, ku humbi titujt kampionë bote në peshën e rëndë. Joshua ka shpërndarë në rrjetet sociale momente nga stërvitja me Okolie, që po e ndihmon për t'u përgatitur

sa më mirë për këtë duel të vështirë. "Kam nevojë të bëj ndryshime në stilin tim të boksimit. Nëse nuk ndryshoj edhe rezultati nuk do të ndryshojë, ndaj po përgatitem ndryshe për

revanshin. Jam i inatosur me veten time dhe kjo është një benzinë që karikon. Vendi i vetëm ku ndihem mirë është palestra, ku përgatitem çdo ditë", ka thënë Joshua.



**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se "Koca Law Office" L.L.C. Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr: 811861097 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavje se svi klienti da drustvo sa "Koca Law Office" L.L.C. Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nr: 811861097 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

All clients are to be informed that the "Koca Law Office" L.L.C. Pristine. has come to the decision to quit its business: 811861097 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

**RESTAURANT****SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

► Agnesa Smajli shpalle të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme SHMLM. "Dr. Xheladin Deda" dhe certifikatën e maturës.

► Isak Krasniqi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "7 Marsi" Prishtinë.

► Azar Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Izvor" Lubinje e Epërme ".

► Kreshnik Tejeci shpall te pavlefshme deftesat e kl I - V dhe VI - IX shfmu " Leke Dugagjini " Prizren.

► Armend Shala shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Abdyl Frasheri " Prizren.

► Fevzije Beka, shpalle te pavlefshme certifikatën e statusit martesor.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoh një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

